

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP
INSTITUTE OF SPIRITUAL AND CULTURAL HERITAGE OF THE ALBANIANS – SKOPJE

STUDIME ALBANOLOGJIKE 19
ALBANOLOGY STUDIES 19

(Revistë e shkencave albanologjike)
(Research-Scientific Journal on Albanology)

Shkup / Skopje, 2019

Kryeredaktor:

Dr. Zeqirija Ibrahim, bashkëpunëtor i lartë shkencor

Redaksia:

Prof. dr. Mirlinda Krifca

Dr. Izaim Murtezani, këshilltar shkencor

Dr. Sevdail Demiri, bashkëpunëtor i lartë shkencor

Dr. Sefer Tahiri, bashkëpunëtor i lartë shkencor

Dr. Hidajete Azizi, bashkëpunëtore shkencore

Sekretare e redaksisë:

Mr. Nora Maliqi

11/5

Këshilli Shkencor Ndërkombëtar:

Prof. Dr. Xhevat Lloshi – Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë – Tiranë

Dr. David Hosaflook – Instituti i Studimeve Shqiptare dhe Protestante – Tiranë ✓

Prof. Dr. Giovanni Belluscio – Universiteti i Kalabrisë – Rende ✓

Prof. Dr. Ke Jing (Gjina) – Universiteti i Gjuhëve të Huaja i Pekinit ✓

Prof. Dr. Ali Jashari – Universiteti “Fan S. Noli” – Korçë

Prof. Dr. Gjon Berisha – Instituti i Historisë “Ali Hadri” – Prishtinë ✓

Prof. Dr. Osman Gashi – Universiteti “Hasan Prishtina” – Prishtinë

Prof. Dr. Anton Pançev – Unversiteti “Shën Kliment Ohridski” – Sofje ✓

Prof. Dr. Leontina Gega-Musa – Instituti Albanologjik – Prishtinë

Prof. Dr. Arben Hoxha – Instituti Albanologjik – Prishtinë

Prof. Asoc. Dr. Pranvera Teli (Dibra), Arkivi Historik i MEPJ, Tirane

Adresa e redaksisë:

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup

Kutia postare nr. 171

1000 Shkup

Republika e Maqedonisë së Veriut

www.itsh.edu.mk

Adresa elektronike:

studimealbanologjike@itsh.edu.mk

studimealbanologjike@yahoo.com

ISSN 1857-6958

UDK 930.85

COBISS.MK-ID 82595850

Editor-in-chief:

Dr. Zeqirija Ibrahim, Senior Fellow Researcher

Editorial Board:

Prof. dr. Mirlinda Krifca

Dr. Izaim Murtezani, Research Adviser

Dr. Sevdail Demiri, Senior Fellow Researcher

Dr. Sefer Tahiri, Senior Fellow Researcher

Dr. Hidajete Azizi, Fellow Resaeacher

Editorial Board Assistant:

Mr. Nora Maliqi

International Advisory Board:

Prof. Dr. Xhevat Lloshi – Institute of Linguistics and Literature – Tirana

Dr. David Hosaflook –Institute of Albanian and Protestant Studies – Tirana

Prof. Dr. Giovanni Belluscio – University of Calabria – Rende

Prof. Dr. Ke Jing (Gjina) – Beijing Foreign Studies University

Prof. Dr. Ali Jashari – Fan S. Noli University – Korça

Prof. Dr. Gjon Berisha – Insitute of History Ali Hadri – Prishtina

Prof. Dr. Osman Gashi –Hasan Prishtina University – Prishtina

Prof. Dr. Anton Pançev –Saint Kliment Ohridski University – Sofia

Prof. Dr. Leontina Gega-Musa – Institute of Albanology – Prishtina

Prof. Dr. Arben Hoxha – Institute of Albanology – Prishtina

Prof. Asoc. Dr. Pranvera Teli (Dibra), Historical Archive of the MEFA, Tirana

Address:

Institute of Spiritual and Cultural Heritage of the Albanians – Skopje

Postal Box 171

1000 Scopje

Republic of North Macedonia

www.itsh.edu.mk

Email Address:

studimealbanologjike@itsh.edu.mk

studimealbanologjike@yahoo.com

ISSN 1857-6958

UDK 930.85

COBISS.MK-ID 82595850

PËRMBAJTJA

Dy fjalë për numrin e ri	7
A Few Words about this New Issue	8
GJUHËSI	9
Qemal MURATI: Gjurmë toponimike “ <i>llatine</i> ” në tërthoret e Maqedonisë, Kosovës dhe Serbisë Jugore	11
Hidajete AZIZI: Gjurmë të antroponimeve të moçme popullore te shqiptarët e Maqedonisë së Veriut.....	15
Zeqirija IBRAHIMI: Proza shkencore e Faik Konicës dhe Fan S. Nolit.....	27
Idaete SINANI: Fonemat bashkëtingëllore në të folmen shqipe të fshatrave me prejardhje nga Reka e Epërme e Gostivarit.....	52
LETËRSI	69
Mirlinda KRIFCA-BEQIRI: Letërsia dhe identiteti	71
Afrim A. REXHEPI: Fiksioni i fiksionit (Surfiction)	83
HISTORI	91
Muhamed MUFAKU/Abdul-hameed AL-KAYYALI/ Hassan HASSAN: Mehdi bej Frashëri si mytesarif i Jerusalemit më 1912; midis qëndrimeve kontradiktore arabe dhe hebraike.....	93
Sevdail DEMIRI/Bunjamin XHEMAILI: Vlera kulmore nga trashëgimia materiale e trevës së Likovës e Kumanovës	114
Isamedin AZIZI: Qëndrimet e delegacionit të Mbretërisë së SKS-së në Konferencën e Parisit.....	129
Naim MUSLIU/Fitim RIFATI: Platforma kombëtare e Kuvendit të Junikut në prag të kryengritjes së përgjithshme të vitit 1912	143
Jeton IDRIZI: Faza e parë e pushtimit të tokave shqiptare nga italianët.....	154
FOLKLOR	165
Bukurije MUSTAFA: <i>Plakat</i> në rrëfimin gojor ballkanik	167
Bekim RAMADANI: Mbi disa veçori të folklorit muzikor shqiptar	173
Ermal MEHMETI: Fillimet dhe tradita e këndimit polifonik në botë	183

METODIKË	193
Shejnaze AJDINI-MURTEZI/Dëfrim SALIU: Të mësuarit e gramatikës së gjuhës frënge nga ana e nxënësve shqiptarë	195
Farketa DIBRA-ZEQIRI: Mësimdhënia dhe të nxëniet e gjuhës	206
KOMUNIKOLOGJI	219
Valdeta KASAPI: Kultura e mediave dhe kultura e të folurit në televizionet nacionale në Maqedoninë e Veriut.....	221
DEMOGRAFI	231
Agron SALIHI: Një vështrim i shkurtër rreth përbërjes fetare të popullsisë së rajonit të Pollogut (1994-2002).....	233
KONTRIBUTE	243
Shpresa MEMEDI: Panteon i fisnikërisë shpirtërore për kombin – Mid’hat Frashëri.....	245
Ismail SYLA: Paragrafët që të mbajnë zgjuar.....	253
RECENSIONE	267
Juljana KUME: Rreth “Fjalorit të termave të shkencës së bibliotekave dhe të informacionit” të autorëve Nermin Basha dhe Luljeta Doda Buza.....	269
Ardian LIMANI: GEORGI N. GEORGIEV: Marrëdhëniet politike bullgaro-shqiptare (1908-1915).....	277
ABSTRACTS	283

MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT E GJUHËS

ABSTRAKT

Ky punim synon të paraqes një pasqyrë rreth mësimdhënies dhe të nxënimit të gjuhës shqipe në një vështrim bashkëkohor, ku nxënësi brenda këtij procesi shihet si faktor i rëndësishëm, i cili duhet t'i zhvillojë ata komponentë komunikues siç janë: të folurit, të dëgjuarit, të lexuarit, të shkruarit, që dallohen për synime dhe objektiva të caktuara. Ne mendojmë se në sistemin tonë arsimor ende nuk po i jepet rëndësi aq sa duhet didaktikës së mësimdhënies së gjuhës shqipe. Shikuar nga e kaluara, por edhe sot, gjithmonë i është dhënë rëndësi parësore përgatitjes së mësuesit, që ai të jetë i aftë ta zotërojë lëndën, që do ta ligjërojë dhe ta përcjellë te nxënësit atë material përkatës për nivelin e tyre. Kjo gjendje bën që nxënësi të mbetet në harresë dhe mos t'i kushtohet rëndësi aq sa duhet të nxënimit prej tij. Si rezultat i kësaj pakujdesie, shumë nxënës ndeshen me vështirësi të dukshme: nuk janë në gjendje për të vëzhguar, vlerësuar, analizuar e interpretuar dukuri, ngjarje e fakte në gjuhën e terminologjisë së lëndëve përkatëse. Nisur nga ky fakt, mendojmë se ka ardhur koha ta parandalojmë këtë gjendje, pra të ndryshohen rolet e mësimdhënies, të investohet te nxënësi, që ai të jetë faktor kryesor brenda procesit mësimor. Në këtë mënyrë, ai do të jetë në gjendje ta kuptojë përgjegjshmërinë e tij gjatë procesit të të nxënimit, pra të nxitet për të vepruar, për t'u përfshirë në diskutime dhe debate të ndryshme mësimore, për të vlerësuar dhe bashkëvepruar për të nxënë.

Falët çelës: mësimdhënia, nxënia e gjuhës, gjuha shqipe, shkolla shqipe, mësimdhënia bashkëkohore

*
* *

Nëse i hedhim një vështrim zhvillimit historik të mësimimit, si proces më i organizuar i veprimtarisë edukativo-arsimor, do të konstatojmë se mësimi në etapa të caktuara historike dhe shoqërore ka kaluar në faza të ndryshme të zhvillimit sa i përket aspektit organizues. Një mësimdhënës efektiv e ka suksesin e garantuar para se të fillojë procesi mësimor, ngase ai di ta organizojë dhe planifikojë orën mësimore, duke vënë në zbatim metoda dhe strategji të avancuara, që korrespondojnë me nivelin e njohurive paraprake gjuhësore të nxënësve. Në këtë vazhdë do të përpiqemi të japim një pasqyrë rreth organizimit të mësimimit tradicional dhe atij bashkëkohor, më konkretisht do t'i krahasojmë epërsitë e metodës bashkëkohore (me në qendër nxënësin) në kontekstin e një krahasimi me metodën tradicionale (me në qendër

mësuesin), për të ardhur në përfundim se cila prej këtyre metodave është më efikase për mësimin e gjuhës: një mësimdhënie tradicionale apo bashkëkohore? Apo, cila nga metodat nxit proceset e larta të të menduarit? Cila prej tyre u ndihmon nxënësve ta përvetësojnë më mirë një informacion të caktuar dhe të bëhen kërkues të pavarur të informacionit?

Fjalët çelës: mësues, nxënës, nxënie, mësimdhënie tradicionale, mësimdhënie bashkëkohore, planifikim, teknologji informacioni dhe komunikimi.

Shoqëria e sotme me një brez rinie të shkolluar, me pretendime socio-kulturore të larta, dita-ditës po ndryshon dhe zhvillohet në të gjitha anët dhe drejtimet. Për të qenë të suksesshëm në këtë shoqëri, domosdo se duhet t'i përshtatemi asaj në mendime, sjellje, gjykime dhe në çdo ndryshim që po ndodh rreth nesh. Të gjitha këto ndryshime nuk e lënë të paprekur edhe sistemin arsimor, sidomos relacionin mësues-nxënës. Ajo që synohet të arrihet është si të formojmë nxënës të përgatitur për t'u bërë ballë ndryshimeve të vrullshme që ndodhin rreth nesh? Mendohet se familja dhe kopshti janë institucionet e parë ku fëmija fillon të flasë, duke mësuar dhe imituar gjuhën që e flasin personat që janë rreth tij. Kjo gjuhë, që mëson fëmija në këtë fazë, është pasqyrë e formimit si individ dhe karakteristikë e të folurit të tij. Mirëpo, fëmijës nuk i mjafton vetëm kaq. Nxitja për ta bërë këtë gjuhë më të pasur, më të larmishme, më estetike dhe më të kompletuar nga ana gjuhësore, është detyrë e rëndësishme e shkollës, sepse aty është vendi më i përshtatshëm ku gjuha kryen një funksion të dyfishtë: së pari, si lëndë kryesore mësimore dhe, së dyti, shërben si gjuhë mësimore për lëndët e tjera që mësohen në shkollë. Duke e vlerësuar gjuhën shqipe si lëndën-bazë në tërë sistemin e edukimit, si çelës të suksesit dhe zhvillimit të nxënësve, mësimdhënia e saj merr një rëndësi të veçantë, ngase nëpërmjet mësimin të gjuhës shqipe në shkollë nxënësi duhet t'i zhvillojë ato komponentë komunikues, siç janë: të folurit, të dëgjuarit, të lexuarit, të shkruarit, që dallohen për synime dhe objektiva të caktuara¹.

Me fjalën mësimdhënie nënkuptojmë t'i ofrosh ndihmë dikujt që ka nevojë të mësojë diçka. Kjo ndihmë zakonisht jepet nga persona kompetentë ose nga mësues. Njerëzit mund të mësojnë edhe pa mësues, në mënyrë të pavarur, por mësimdhënia s'mund të realizohet pa nxënës. Mësimdhënia "*është faktori kryesor në realizimin e mësimnxënies; është akti i të dhënit mësim në një institucion arsimor; është veprimtaria dhe drejtimi i procesit mësimor nga mësuesi.*"² Në praktikën e sotme në fushën e didaktikës mësimdhënia është vlerësuar si një proces që bashkon artin me shkencën. Arti i mësimdhënies nënkupton një mësimdhënie me metoda sa më të përsosura, të cilat lënë gjurmë në mendjen e nxënësit. "Mësimdhënia si "art" mbështetet fuqishëm në intuitën, e cila është bazë për veprim"³, ndërsa "mësim-

¹ Mimoza Gjokutaj, *Didaktika e gjuhës shqipe*, SHBLU, Tiranë, 2009, f. 5-6

² Kozma Grillo, *Fjalor edukimi*, 2002, f. 182.

³ <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2013/10/Doktoratura-Besnik-Rama-Fakulteti-i-Histori-Filologjise-Departamenti-i-Gjuhesise.pdf>, marrë më 15. 06. 2019.

dhënia si "shkencë" varet në mënyrë parësore në modelin e drejtuar nga qëndrime bihevisoriste. Në këndvështrimin e parë mësimdhënia kryhet me një metodë më spontane dhe subjektive, ndërsa në të dytin procesi i mësimit merret si ndërveprim i nxitjes (ngacmimit) dhe përgjigjes me çdo shprehje të ndarë, zbërthyer me detyra dhe proceduara përbërëse".⁴

Nëse i hedhim një sy gjendjes reale në të cilën jetojmë dhe veprojmë, mendojmë se në sistemin tonë arsimor ende nuk po i jepet rëndësi aq sa duhet didaktikës së mësimdhënies së gjuhës shqipe. Shikuar nga e kaluara, por edhe sot, gjithmonë i është dhënë rëndësi parësore përgatitjes së mësuesit, që ai të jetë i aftë ta zotërojë lëndën që do ta ligjërojë dhe të përcjellë te nxënësit atë material përkatës për nivelin e tyre. Kjo gjendje bën që nxënësi të ngelet në harresë dhe mos t'i kushtohet rëndësi aq sa duhet të nxënimit prej tij. Si rezultat i kësaj pakujdesie, shumë nxënës ndeshen me vështirësi të dukshme dhe nuk janë në gjendje për të vëzhguar, vlerësuar, analizuar e interpretuar dukuri, ngjarje e fakte në gjuhën e terminologjisë së lëndëve përkatëse. Të mësuarit e gjuhës amtare në shkollë na vë përpara dy detyrave kryesore, si:

- t'i bëjmë nxënësit ta kuptojnë gjuhën në të gjitha shfaqet e saj të pasura;
- t'u mësojmë atyre përdorimin e të shprehurit me gojë dhe me shkrim në marrëdhënie me njerëzit e tjerë.

Këto dy elemente të rëndësishme, në qoftë se zotërohen mirë nga ana e nxënësve që në fazën fillestare, atëherë problemi i mësimt dhe përdorimit të gjuhës do të ishte një punë pothuajse tejet e lehtë, si për nxënësin, ashtu edhe për mësimdhënësin.

Nisur nga ky fakt, mendojmë se ka ardhur koha që ta parandalojmë këtë gjendje d.m.th. të ndryshohen rolet e mësimdhënies, të investohet te nxënësi, që ai të jetë faktor kryesor brenda procesit mësimor, pra të jetë në gjendje ta kuptojë përgjegjshmërinë e tij gjatë procesit të të nxënimit, pra të nxitet për të vepruar, për t'u përfshirë në diskutime dhe debate të ndryshme mësimore, për të vlerësuar dhe bashkëvepruar për të nxënë. Pra, mësimdhënia në fushën e gjuhës duhet të jetë sa më transparente, që nxënësit ta zhvillojnë aftësinë e mendimit kreativ e kritik, që në të ardhmen të jenë të përgatitur për të ndërmarrë përgjegjësi dhe vendime nga më të ndryshmet, si brenda procesit mësimor, ashtu edhe në jetë. Që ky proces të rezultojë i suksesshëm, mësimdhënia kërkon "*një kurrikulë e cila duhet ta përcjell atë informacion dhe atë aktivitet që në kontekstin kohor paraprihen nga koherenca me zhvillimet sociale, globale të shoqërisë dhe të shkollës*".⁵

Në dekadën e fundit në sistemin tonë arsimor është bërë përpjekje për ndryshime në këtë drejtim, por rezultatet e arritura janë të pakta dhe lënë për të dëshiruar. Për të reflektuar një frymë pozitive dhe për të përgatitur nxënës që do t'u përgjigjen standardeve të një tipi të ri, të përshtatshme me kërkesat e kohës, nevojiten disa ndryshime në kurrikulën tonë shkollore. Para se gjithash kërkohet një rritje e

⁴ Grup autorësh (Donald C. Orlich, Robert J. Harder, Richard C. Callahan, Konstance H. Kravas, Donald H. Kauchak, R. A. Pendegrass, Andrew J. Keogh), *Strategjia e të mësuarit*, Eureka, Tiranë, 1995, f. 10.

⁵ Mimoza Gjokutaj, *Didaktika e gjuhës shqipe*, SHBLU, Tiranë, 2009, f. 264.

numrit të orëve për lëndën e gjuhës dhe letërsisë shqipe, do të ndihmonte jashtëzakonisht procesin e mësimdhënies dhe nxënies. Tekstet shkollore të gjuhës dhe letërsisë shqipe duhet ndryshuar, sepse nuk ofrojnë përmbajtje në përputhje me të arriturat bashkëkohore të fushës së caktuar shkencore, me metodologjinë e mëimit të lëndës dhe përdorimin e terminologjisë profesionale; duhet pasuruar kurriula edhe me tekste alternative dhe me libër mësuesi, ku mësimdhënësit do të kenë mundësi të ndryshme për të menduarit kritik gjatë shkrim-leximit. Një ndihmesë të pakrahasueshme në këtë drejtim do të japin trajnimet dhe seminarët e herëpashërshme, ku mësuesit do të jenë në gjendje të mësojnë strategji dhe metoda të reja efikase mësimore për t'i zbatuar në praktikë, me të vetmin qëllim përsosmërinë e mësimdhënies dhe ngritjen e cilësisë në arsim. Që mësimdhënia dhe të nxëniet të reflektojnë si të suksesshme, mjetet mësimore duhet të zënë një vend të rëndësishëm brenda këtij procesi. Kurrikula jonë është e vobektë në këtë drejtim, sepse mungojnë mjetet mësimore (kompjuter në çdo klasë, televizor, mësimi kabinetik, vizitat nëpër panaire dhe organizime të ndryshme me karakter gjuhësor dhe letrar, etj.). Kjo infrastrukturë e pamjaftueshme ka nevojë për një ndërhyrje, ngase ndryshimet e lartpërmendura i mundësojnë nxënësit ta drejtojnë vëmendjen drejt një të ardhmeje të realizueshme, të afërt dhe të mundshme, që do t'u përgjigjet standardeve të një tipi të ri, të përshtatshme me kërkesat e kohës. Një rol të rëndësishëm gjatë realizimit të këtij procesi luan planifikimi i punës së mësuesit, sepse suksesi i çdo lënde varet nga përsosmëria e planit dhe nga shkathhtësia me të cilin realizohet plani.

Planifikimi i mësimdhënies produktive

Çdo mësimdhënës niset me idenë se do të jetë i suksesshëm në punën e tij, por jo gjithmonë ndodh kjo. Mësimdhënia e suksesshme është një aktivitet, i cili në brendi përfshin shumë elemente, të cilat udhëhiqen nga mësimdhënësi-nxënësi. Një element dallues i këtij aktivitetit është procesi që quhet planifikim. Planifikimi bëhet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, më konkretisht nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit. Ata i nxjerrin edhe kërkesat e kurrikulës. Edhe pse planifikimi bëhet nga organet e larta shtetërore, përgjegjësia për t'i përcaktuar objektivat e lëndës, të kapitujve dhe njësive mësimore, bie tërësisht te bartësi i lëndës, d.m.th. mësuesi. Nëse mësuesi dëshiron ta realizojë orën mësimore në mënyrë sistematike, ai duhet t'ia kushtojë një pjesë bukur të mirë të kohës planifikimit. "*Planifikimi i orës mësimore e bën mësuesin më të strukturuar, më të organizuar, e ndihmon dhe i radhit çështjet sipas një radhe të caktuar*".⁶ Është e pamundur që nxënësit të përballohen brenda një orës mësimore nëse mësuesi nuk ka planifikuar "si" dhe "çfarë" do t'u mësojë nxënësve, pra duhet t'i caktojë objektivat e orës së mëimit, cila është përmbajtja e saj dhe si realizohen ato. Rrjedhimisht, planifikimi i përgji-

⁶ Bardhyl Musai, *Mjeshtritë themelore të mësimdhënies*, Tiranë, 1997, f. 83.

⁶ Po aty, f. 83.

gjatë motos: "të vendosësh se çfarë do të arrish, në ç'mënyrë do ta arrish dhe të tregosh se çfarë është arritur".⁷ Me fjalë të tjera, "duhet të vendosim se çfarë presim nga nxënësit dhe çfarë do të mësojnë ata, si pasojë e instruktimit tonë. Këto quhen "produktet e të mësuarit" dhe përfshijnë: njohuritë (faktet, konceptet, qëndrimet dhe ndjesitë) dhe shkathtësitë ose çdo të bëjë një nxënës me njohuritë dhe qëndrimet e fituara".⁸ Nëse nxënësit nuk i njohin objektivat që duhet t'i arrijnë brenda një ore mësimore, ka mundësi që ata të mësojnë në mënyrë mekanike dhe të mos e realizojnë aktivitetin e duhur për t'i përvetësuar njohuritë. Në nivelin e mësimdhënies, objektivat janë përcaktime për përvetësimin e mësimit nga nxënësi, pra nuk shpjegohet se çfarë do të bëjë mësuesi, por çfarë do të jetë i aftë të bëjë nxënësi. Meqenëse planifikimi i mësimit është një detyrë e dobishme, mësuesi duhet të përqendrohet gjithmonë në bashkëveprimin midis asaj që duhet mësuar dhe nxënësit. Pra, që mësimdhënia të rezultojë si e suksesshme, mësuesi duhet t'i seleksionojë objektivat, duke marrë në konsideratë natyrën e lëndës, nevojat e nxënësve, karakteristikat e nxënësve (interesat, aftësitë, qëndrimet), karakteristikat tona si mësues (filozofia mësimore, prirjet dhe potenciali), lehtësinë që e kemi në dispozicion (pajisjet, orënditë, kohën e nevojshme) etj. (Garo, 2011: 70).

Në fillim të vitit shkollor mësuesi njihet me nxënësit dhe e mat nivelin e arritjes së tyre. Në bazë të kësaj ai e ka idenë se ç'lloj i të nxënësve është i përshtatshëm për nxënësit e tij dhe si ta zhvillojë mësimin që ta lehtësojë të nxënësve. Pjesa dërmuese e mësuesve janë në gjendje t'i kuptojnë qëllimet arsimore dhe t'i zbërthejnë ato në kushte të përshtatshme mësimore, por ekziston edhe një pjesë mësimdhënësish, që akoma nuk e kanë të qartë se si bëhet përzgjedhja e përmbajtjes së materialit për shpjegim, pra nuk i përcaktojnë objektivat mësimore. Në praktikë ata nuk bëjnë planifikim, pra ndjekin një procedurë të thjeshtë: shkruajnë temat e librit, e shqyrtojnë plan-programin dhe nëse programi nuk ka dallime nga viti i kaluar, atëherë e kopjojnë të njëjtin plan edhe për atë vit. Parashtrahet pyetja: a mund të arrijmë t'i realizojmë objektivat në këtë mënyrë? Kuptohet që jo. Edhe pse teksti mësimor mund të jetë i njëjtë, niveli i nxënësve, materialet mësimore dhe kushtet në të cilat mësohet mund të jenë të ndryshme. Edhe pse në sistemin tonë arsimor brenda çdo plan-programi janë përcaktuar mirë qëllimet dhe objektivat e të gjitha niveleve, mësuesi përsëri ka liri ta organizojë planifikimin e orës dhe atij i ngarkohet përgjegjësia për të gjitha vendimet e marra. Pra, një hap të rëndësishëm brenda këtij procesi luan mësuesi. Ai duhet të vendosë për kohën që do ta shpenzojë për çështjet dhe temat e ndryshme. Shumica e mësimdhënësve e neglizhojnë këtë hap, sipas së cilit në fillim të vitit shkollor kemi një ecuri të ngadalshme të dhënies së njohurive, ndërsa javët e fundit – për shkak të mungesë së kohës – shumë njohuri dhe shkathtësi tejkalohen.⁹ Një praktike e tillë e lë pas nxënësin, ku si rezultat i një planifikimi jokorrekt nga mësuesi, një pjesë e mirë e materialit mbetet e papërvetësuar nga nxënësit.

⁷ Sofokli Garo, *Metodologjia dhe praktika e mësimdhënies*, U.F.O. Press, 2001, f. 69.

⁸ Po aty, f. 69.

⁹ Sofokli Garo, *Metodologjia dhe praktika e mësimdhënies*, U.F.O. Press, 2001, f. 81

Nga sa u tha më lart, qëllimet dhe funksionet e planifikimit të mësimit janë të shumta. Së pari, planifikimi ndihmon mësuesin të mendojë qartë për tipin e të nxënësve, pra t'i lidhë objektivat mësimore me atë që di për nxënësin dhe me vendin që zë mësimi në programin e lëndës. Së dyti, planifikimi e ndihmon mësuesin edhe për strukturën dhe përmbajtjen e mësimit, duke mbajtur llogari edhe për kohën që do ta harxhojë për secilën veprimtari mësimore. Së treti, planifikimi i mirë e zvogëlon në mënyrë të konsiderueshme kohën që mësuesi duhet të mendohet gjatë mësimit, për zhvillimin e tij. Së katërti, planifikimi çon në përgatitjen e të gjitha materialeve, burimeve dhe, në përgjithësi, të pajisjeve që nevojiten. Qëllimi i pestë është mbajtja e shënimeve në fund të mësimit, çka mund të sigurojnë një orientim të vlefshëm për planifikime në të ardhmen¹⁰.

Në këtë vazhdë, si mësues të suksesshëm llogariten ata *"të cilët janë në gjendje të vërtetojnë aftësitë e tyre për të realizuar planifikimin"*¹¹ e një ore mësimore. *"Është e qartë se nuk mund të flasim për mjeshtëri të përkryera të planifikimit të mësuesit, por duke u bazuar në përmbajtjen e punës së mësuesit, në përvojën tonë, dhe në atë të përparuar evropiane dhe më gjerë"*¹² kriteret kryesore për të konstatuar se një mësues është i suksesshëm në punë e tij janë:

- Planifikon dhe paraqet materialin në një linjë logjike;
- E vendos mësimin në nivelin e nxënësve dhe i merr parasysh dallimet individuale të tyre;
- Krijon mundësi për ta praktikuar dhe aplikuar atë që është mësuar;
- U mundëson nxënësve të dinë çfarë pritet nga ata;
- I monitoron dhe vlerëson arritjet e nxënësve dhe, në një mënyrë, u krijon mundësi të mësojnë nga gabimet.

Varësia dhe ndër lidhja që krijohet midis këtyre elementeve, duke ia dhënë secilit vendin e rëndësishëm në klasë, është shumë e rëndësishme për një mësues të suksesshëm. Pra, krijohet një kombinim ndërmjet përmbajtjes, objektiveve të të nxënësve, materialeve të mësimit dhe punës së vetë nxënësve, që sigurojnë marrjen e vendimeve për lidhjen më të përshtatshme të këtyre cilësive. Të gjitha këto elemente arrihen të realizohen në situata të ndryshme mësimore, ku nxënësi është në qendër të mësimit. Këtë mundësi ia ofron nxënësve vetëm mësuesi që realizohet me metoda, teknika dhe strategji bashkëkohore, të cilën do ta trajtojme në vazhdim të punimit.

Mësimdhënia tradicionale dhe bashkëkohore

Praktika e sotme dëshmon se në momentet që po kalon arsimit në mbarë globin problemet e mësimit dhe të nxënësve janë bërë shumë të ndjeshme dhe të diskutueshme, madje mësuesit çdo ditë e më tepër janë në kërkim të zbulimit të metodave dhe teknikave bashkëkohore të organizimit të mësimit, të cilat i mundë-

¹⁰ Bardhyl Musai, *Mjeshtëritë themelore të mësimit*, Tiranë, 1997, f. 83-84.

¹¹ Po aty, f. 17.

¹² Po aty, f.23.

sojnë nxënësit një përgatitje të mirë, duke e aftësuar që të realizojë një të nxënë në mënyrë të pavarur; të zhvillojë aftësi komunikuese, menaxhuese, organizuese; të nxisë vetëvlerësim dhe vlerësim të përshtatshëm rreth rezultateve mësimore etj. Përzgjedhja e metodave të mësimdhënies në përshtatje me qëllimet dhe synimet që duhet të arrihen është një nga rrugët më të mira aktive, përmes të cilave duhet të përfshihen nxënësit në procesin e të nxënit¹³.

Filozofi i njohur grek Platoni ka thënë: *"Mos e edukoni një fëmijë me forcë ose ashpërsi, por drejtojeni ata në rrugën e edukimit, duke përdorur ato gjëra që argëtojnë mendjet e tyre, kështu ju do të jeni në gjendje të kuptoni me saktësi prirjet dhe aftësitë gjeniale të secilit prej tyre."*¹⁴ Kjo thënie na bën të mendojmë: vallë, a kemi mësuar dhe punuar si duhet sa i përket mënyrës së organizimit të mësimdhënies?; mos vallë kemi punuar me metoda të gabuara deri para pak viteve?; mbase kemi qenë tepër të rreptë ndaj vlerësimit të nxënësve dhe disiplinës në klasë? Për të hedhur dritë mbi këto çështje, është e udhës të bëjmë një krahasim mes mësimdhënies tradicionale dhe asaj bashkëkohor, për të ardhur në përfundim se cila prej tyre ka epërsi dhe dobi më të mëdha, çfarë hapash duhet të ndërmerim më tej, që t'i arsimojmë dhe edukojmë nxënësit drejt zbatimit të njëres ose tjetres metodë mësimdhënieje, e cila do ta lehtësonte të nxënit e nxënësve dhe pjesëmarrjen a tyre aktive brenda këtij procesi kaq të rëndësishëm jetësor.

Nëse e kthejmë kokë disa dekada më parë, kur mbizotëronte mësimdhënia tradicionale, do të vërejmë një orë mësimore të zhvilluar mbi bazë të këtyre etapave: kontrollimi i detyrave të shtëpisë, kontrollimi i njohurive të fituara, shpjegimi i njësisë së re mësimore, përsëritja e njësisë së mësuar dhe dhënia e detyrave të shtëpisë. Sipas kësaj ecurie, 70% të orës mësimore e harxhonte mësuesi me aktivitetin e vet, ku ligjëronte vetëm ai, në pozicion frontal, duke u bazuar në një bindje të gabuar se nëse flet më shumë ai, nxënësit do të mësojnë më tepër. Nxënësi brenda 45 minutave duhej vetëm të dëgjonte dhe të përgjigjej kur i parashtroheshin pyetje. Në këtë mënyrë nxënësit i servohej informacioni i gatshëm nga mësuesi, pa u angazhuar në mësim, por nuk i jepej e drejta ta kundërshtojë informacionin, jo vetëm për faktin se mësuesi ishte figura qendrore brenda atij procesi, por mungonin dukshëm edhe burimet e informacionit me të cilat shërbehemi sot. Gjatë zbatimit të kësaj metode mësimdhënieje nxënësi duhej të ishte patjetër pjesëmarrës brenda orës mësimore, sepse kjo i imponohej nga mësuesi. Në të kundërtën, do të merreshin masa ndëshkimore.

Shikuar nga këndvështrimi i sotëm, kjo metodë sjellë një pasivitet të plotë dhe monotoni për nxënësin, duke reflektuar situata të palakmuara në ambientin e klasës, ngase vjen në shprehje një orë e mbingarkuar me njohuri të panevojshme dhe plot përsëritje informacioni, ku në qendër është aktiviteti i mësuesit, e jo nxënësit. Si rrjedhojë, vërejmë se "mësimi tradicional është më shumë teorik dhe memorizues, pra nuk ka si qëllim të zhvillojë aktivitete për t'i stimuluar nxënësit ta përdorin informacionin e marrë në situata reale, prandaj nxënësit humbasin

¹³ Mimoza Gjokutaj, *Didaktika e gjuhës shqipe*, SHBLU, Tiranë, 2009, f. 283

¹⁴ <http://iipcccl.org/wp-content/uploads/2017/12/Vol.-1-ICES-IV.pdf>, marrë më 26. 05. 2019.

interesin për mësim. Ndonëse kjo metodë ka si parim që nxënësit ta mësojnë dhe ta riprodhojnë informacionin e marrë, ajo nuk është efektive, sepse një informacion i mësuar mund të harrohet lehtë, ngase të mësuarit e tij mbetet thjesht te memorizimi dhe riprodhimi".¹⁵

Mangësia e mësimin tradicional qëndron te planifikim jokorrekt, që shkon në epërsi të mësuesit, duke e orientuar një mësimdhënie me në qendër mësuesin, ndërsa nxënësi, brenda këtij procesi, nuk ka mundësi argëtimi, që mësuesi t'i kuptojë prirjet gjeniale të secilit nxënës në veçanti dhe mbi bazë të tyre të veprojë për ta planifikuar dhe organizuar orën mësimore. Prandaj, kohëve të fundit gjithnjë e më shumë bëhet përpjekje që të dilet nga kjo situatë, të zhvishet petku i metodës tradicionale, ku nxënësi pranon dituri të gatshme, të cilat duhet t'i regjistrojë në kujtesë dhe t'i përsërisë, por synohet që ai të ndërtojë dituri në bazë të mësimin aktiv, të kuptueshëm, të cilat do t'i ndihmojnë për të zhvilluar aftësi të të menduarit të nivelit të lartë. Një ndër faktorët që gjithnjë e më shumë i rrit kërkesat drejt gjurmimit të metodave, strategjive dhe formave të reja mësimore, të cilat do ta kundërshtojnë metodën e lartpërmendur dhe do të kontribuojnë në mësimdhënien bashkëkohore ndërvepruese (interaktive), për t'i ardhur në ndihmë procesit të mësimdhënies dhe të nxënës, padyshim se është zhvillimi i komunikimit përmes teknologjisë, që sot e ka pasuruar në një masë të madhe informacionin. Mësuesi duhet të jetë një përdorues i teknologjisë së re, pra ai duhet ta shohë veten në pozicionin e një nxënësi që mëson së pari për vete dhe për t'i mësuar të tjerët. Në këtë mënyrë do të jetë në gjendje të formojë nxënës për t'iu përgjigjur standardeve të reja, të përshtatshme me kërkesat e kohës¹⁶.

Sot mësuesit kanë mundësi të pafundme informacioni, ku mund të shërbehen për të ndryshuar rolet e mësimdhënies, ngase mësimdhënia bashkëkohore nënkupton modifikim rolesh, me qëllim lehtësimin e të nxënës. Mësuesi është ai i cili modifikon, udhëheq, organizon, nxit debate, ndërsa nxënësi, i cili më parë kishte për detyrë vetëm të dëgjojë dhe të përgjigjet në pyetjet që i parashtraheshin, tani është përfshirë në të gjitha aktivitetet e mësuesit dhe vepron bashkërisht me të dhe me nxënësit e tjerë. "Gjatë veprimtarive mësimore nxënësit krijojnë, bashkëbisedojnë, diskutojnë, shqyrtojnë, zgjidhin problemet, zbulojnë (hetojnë), kritikojnë, analizojnë, gjykojnë. Pra, nxënësi mendon për atë që mëson, e përdorë në jetën e përditshme, ndërton përvojën dhe aftësohet për të punuar në mënyrë të pavarur"¹⁷. Të gjitha këto aktivitete mund të arrihen me realizimin e formave të ndryshme të punës mësimore (puna në çifte, puna në grupe, puna individuale etj.) dhe modeleve të ndryshme të mësimdhënies, të cilat e vendosin në qendër të vëmendjes nxënësit, marrin për bazë potencialet dhe aftësitë individuale të nxënësve, bëjnë që të përfshihen të gjithë nxënësit, pavarësisht nga vështirësitë që ata kanë.

¹⁵ <http://iipcccl.org/wp-content/uploads/2017/12/Vol.-1-ICES-IV.pdf>

¹⁶ Mimoza Gjokutaj, *Didaktika e gjuhës shqipe*, SHBLU, Tiranë, 2009, f. 264

¹⁷ Shih: Besnik Rama, *Metodat e mësimdhënies dhe ndikimi i tyre në të nxënë*, Revista pedagogjike, Tiranë, f. 30

Ajo që pretendohet të arrihet përmes zbatimit të metodave bashkëkohore të mësimit është që mësuesit të jetë në gjendje të dallojnë "jo vetëm atë që di, por edhe atë që është në gjendje të bëjë nxënësi"¹⁸ me njohuritë e fituara, duke vënë në aktivizim kujtesën logjike të nxënësit, për të arritur një standard që e kemi përcaktuar më parë. Pra, ora mësimore "është gjithmonë një bashkëveprim dinamik i individëve (mësues me mësues, mësues me nxënë, nxënës me nxënë), në të cilin të gjithë vazhdimisht marrin vendime".¹⁹

Përkitazi me këtë duhet pasur kujdes edhe gjatë përdorimit me vend të metodave dhe teknikave bashkëkohore që e zhvillojnë mendimin kritik dhe krijues të nxënësve, ngase qëllimi nuk është vetëm zbatimi i tyre, por mësimit duhet të dijë se kur dhe si t'i përdor ato. P.sh. nuk ka rezultat përdorimi i teknikës së rrushit, kur kalaveshët e rrushit i plotëson mësimit nxënësi e jo nxënësi ose mësuesi e përdor teknikën e diagramit të venit, mirëpo kur teknika plotësohet nga mësimit nxënësi, efekti i përdorimit të saj është i barabartë me metodën tradicionale, se vjen në shprehje aktiviteti i mësimit nxënësit e jo nxënësit. E rëndësishme është që strategjitë dhe teknikat që përdoren gjatë mësimit të jenë në përputhje me parimet e mësimit. Mësuesi duhet t'i përdorë ato në mënyrë elastike, më konkretisht gjatë mësimit të bëjë përshtatje të teknikave, në mënyrë që çdo nxënës, të paktën për një pjesë të kohës, të gjejë një situatë të të mësuarit në përshtatje me stilin e tij konjitiv, t'i ndihmojë nxënësit të përpunojnë stile të mësuarit në përshtatje më përmbajtjen e lëndës, që jo vetëm të ndalen në konceptet, por edhe t'i praktikojnë dhe t'i përdorin ato.²⁰

Ky trajtim i pasqyruar më lart na jep mundësinë të kuptojmë se deri para pak viteve kemi mbrojtur, praktikuar dhe jemi mburrur me përdorimin e metodës së mësimit tradicionale, e cila në qendër të orës e kishte mësuesin si bosht kryesor që e mbante baraspeshën e klasës. Duke parë epërsitë e mësimit bashkëkohore, konstatoam se gjatë përdorimit të metodës tradicionale nxënësi nuk aktivizohej me vetëdëshirë, nuk kishte motivim dhe interesim për mësim, informacioni merrej i gatshëm nga mësimit nxënësi, pra bazohej thjesht në memorizimin afatshkurtër dhe riprodhimin e informacionit në mënyrë mekanike, e cila shpejt harrohej. Nëse i referohemi mësimit bashkëkohore, vërejmë një orë mësimore në të cilën ka kushte për mësim cilësor, ekziston vetëmotivimi, aktivizimi dhe përqendrimi i nxënësve brenda procesit mësimor, ku nxënësit janë të aftë për të analizuar, krahasuar e gjykuar çdo informacion që u jepet dhe janë në gjendje "të mbajnë qëndrime kritike për probleme dhe situata konkrete gjatë të cilave u kërkohet të marrin vendime të rëndësishme".²¹ Nëse gjatë mësimit tradicionale 45 minuta ishte aktiv thuhet vetëm mësuesi, gjatë mësimit bashkëkohore detyra e tij ndryshon dhe roli i tij në mësim është të orientojë proceset e të menduarit të nxënësve

¹⁸ Shih: Mimoza Gjokutaj, *Didaktika e gjuhës shqipe*, SHBLU, Tiranë, 2009, f. 262.

¹⁹ Shih: grup autorësh (Donald C. Orlich, Robert J. Harder, Richard C. Callahan, Konstance H. Kravas, Donald H. Kauchak, R. A. Pendegrass, Andrew J. Keogh), *Strategjia e të mësuarit*, Eureka, Tiranë, 1995, f. 10.

²⁰ Sofokli Garo, *Metodologjia dhe praktika e mësimit*, U.F.O. Press, 2001, f. 10

²¹ Shih: Mimoza Gjokutaj, *Didaktika e gjuhës shqipe*, SHBLU, Tiranë, 2009, f. 275.

drejt niveleve më të larta, të kultivojë shprehitë e zgjedhjes së problemeve dhe të marrjes së vendimeve, në kushte të reja e të panjohura më parë prej tyre.²² Në këtë mënyrë ai e mban nën kontroll situatën. Modifikimet e shumta si dhe kombinimet që mundëson ky sistem i organizimit të punës mësimore krijojnë mundësi për ngritjen e efikasitetit sa më të madh të veprimtarisë edukativo-arsimorë në mësim dhe të punës së nxënësve në zhvillimin e aftësive individuale të tyre.

Ne gjykojmë se do të ishte një hap pozitiv dhe sukses i madh nëse të gjithë mësimdhënësit do të ishin këmbëngulës drejt zbatimit të një mësimdhënieje me metoda bashkëkohore, të njohura, por jo shumë të përhapura në arsimin shqiptar. Një qëndrim i tillë u siguron një paraqitje dhe përgatitje të mirë nxënësve, duke qenë se bazohet në njohuri të qëndrueshme dhe afatgjate, pra ofron mundësi të shumta për ta orientuar nxënësin drejt njohjes së të ardhmes së realizueshme, të afërt dhe të mundshme.

Për t'i konkretizuar idetë e mësipërme në vazhdim të punimit në mënyrë skematike do të paraqesim krahasimin ndërmjet mësimin tradicional dhe bashkëkohor.

Mësimi tradicional	Mësimi bashkëkohor
Planifikohet realizimi i një ore prej 45 minutash	Planifikohet realizimi i një ore, por edhe i një tërësie më të vogël (një pjese të orës) ose më të madhe se një orë (dy orë bashkë, bllok orë, cikël të më shumë orëve etj.)
Në të shkruan se se ç'bën mësuesi , si do ta realizojë orën.	Theksi vihet në atë që e punojnë nxënësit , duke i dhënë kështu specifikat e situatave të mësimin (që duhet t'i nxisin aktivitetet për përmbajtjet dhe lëndën) dhe aktivitetet e nxënësve (që do të nxiten në ato situata).
Shkruhet përmbajtja (Çka punohet, orari i mësimorë dhe artikulumet kohor gjatë nxitjes së metodave mësimore dhe mjeteve didaktike që do të përdoren).	Dominon Si do të nxitë ndonjë aktivitet të caktuar të nxënësve dhe cilat aktivitete do të nxiten, interaksioni pedagogjik ndërmjet nxënësve dhe ndërmjet arsimtarit dhe nxënësve. Kjo do të thotë se theksi vihet në metodat e mësimin gjatë të mësuarit dhe atë specifike për lëndën gjegjëse.
Më së shumti i jepet vlerë realizimit të orës.	Më së shumti i jepet vlerë përgatitjes para orës dhe idesë së mësimin, e cila me sukses do të realizojë qëllimet e caktuara (përgatitja merr më shumë kohë se vetë realizimi i orës – nga ardhja e idesë deri të krijimi i situatës mësimore).
Përgatitja me shkrim ka pothuajse strukturë uniforme : hyrje, rrjedhë, përfundim (prej këtu shfaqet edhe rreziku i shablonizimit, përshkrimin mekanik të përgatitjes për orë, për vete dhe për të tjerët).	Nuk mund të ketë strukturë fikse uniforme (kjo do të thotë nuk duhet të jepen edhe disa të dhëna elementare për përmbajtjen mësimore, për qëllimet, për moshën etj.), por kjo duhet të jetë strukturë e ndryshueshme e skenarit varësisht nga ideja e autorit.
Dominon roli ligjërues i arsimtarit dhe pjesërisht edhe roli organizativ.	Dominon: roli organizativ (regjisorial, disenjator), motivues dhe roli i arsimtarit si partner i interaksionit pedagogjik .

²² Shih: Bardhyl Musai, *Metodologjia e mësimdhënies*, Albgraf, Tiranë, 2003, f. 12.

Rezime

Ndryshimet e fundit të zhvillimit të shkencës dhe teknologjisë kanë transformuar botën në të gjitha anët dhe drejtimet, këta ndryshime reflektohen edhe në sistemin arsimor, e sidomos në raportin mësues-nxënës. Ajo që pretendohet të arrihet është, si të jemi të suksesshëm në këtë drejtim, për t'i sfiduar të gjitha vështirësitë që ndodhin gjatë procesit të mësimdhënies dhe të nxënies, dhe për të përgatitur nxënës të aftë e me njohuri të qëndrueshme gjuhësore. Për t'u përshtatur në këtë furi ndryshimesh, nxënësi duhet t'i zhvillojë dhe përsos aftësitë e të folurit, të shkruarit, të lexuarit, të dëgjuarit. Përvetësimi i këtyre aftësive nënkupton njohjen dhe zbatimin e drejt dhe me vend të njohurive gjuhësore. Pra, suksesi i nxënësit në këtë drejtim, diktohet nga aftësia dhe përgatitja profesionale e mësimdhënësit, i cili duhet të synojë të realizojë një mësimdhënie në fushën e gjuhës sa më transparente, që nxënësit ta zhvillojnë aftësinë e mendimit kreativ e kritik, që në të ardhmen të jenë të përgatitur për të ndërmarrë përgjegjësi dhe vendime nga më të ndryshmet, si brenda procesit mësimor, ashtu edhe në jetë.

Për të përgatitur nxënës, që t'u përgjigjen standardeve të një tipi të ri, të përshtatshme me kërkesat e kohës, mësimdhënia dhe të nxënies e gjuhës, kërkon "*një kurrikulë e cila duhet ta përcjell atë informacion dhe atë aktivitet që në kontekstin kohor paraprihen nga koherenca me zhvillimet sociale, globale të shoqërisë dhe të shkollës*".²³ Në këtë drejtim kurrikula jonë shkollë është e vobektë, ka nevojë për ndërhyrje. Para se gjithash, erdhëm në përfundim, se një rritje e numrit të orëve për lëndën e gjuhës dhe letërsisë shqipe do të ndihmonte jashtëzakonisht procesin e mësimdhënies dhe nxënies së gjuhës. Tekstet shkollë të gjuhës dhe letërsisë shqipe duhet ndryshuar, sepse nuk ofrojnë përmbajtje në përputhje me të arriturat bashkëkohore të fushës së caktuar shkencore, me metodologjinë e mësimin të lëndës dhe përdorimin e terminologjisë profesionale; duhet pasuruar kurrikula edhe me tekste alternative dhe me libër mësuesi, ku mësimdhënësit do të kenë mundësi të ndryshme për të menduarit kritik gjatë shkrim-leximit. Një ndihmesë të pakrahueshme në këtë drejtim do të jepnin trajnimet dhe seminarët e herëpashershme, ku mësuesit do të jenë në gjendje të mësojnë strategji dhe metoda të reja efikase mësimore për t'i zbatuar në praktikë, me të vetmin qëllim përsosmërinë e mësimdhënies dhe ngritjen e cilës në arsim. Që mësimdhënia dhe të nxënies e gjuhës të reflektojë e suksesshme, mjetet mësimore duhet të zënë një vend të rëndësishëm brenda këtij procesi.

Një rol parësor gjatë realizimit të këtij procesi luan planifikimi i punës së mësuesit, sepse suksesi i çdo lënde varet nga përsosmëria e planit dhe nga shkathtësia me të cilin plani realizohet. Meqenëse, planifikimi i mësimin është një detyrë e dobishme, mësuesi duhet të përqendrohet gjithmonë në bashkëveprimin midis asaj që duhet mësuar dhe nxënësit. Bazuar nga ajo që trajtuam në punim, konstatuam se ekziston edhe një pjesë mësimdhënësish, të cilët akoma nuk e kanë të qartë se si bëhet për-

²³ Shih: Mimoza Gjokutaj, *Didaktika e gjuhës shqipe*, SHBLU, Tiranë, 2009, f. 264.

zgjedhja e përmbajtjes së materialit për shpjegim, pra nuk i përcaktojnë objektivat mësimore. Në praktikë ata nuk bëjnë planifikim, pra ndjekin një procedurë të thjeshtë: shkruajnë temat e librit, e shqyrtojnë plani-programin dhe nëse programi nuk ka dallime nga viti i kaluar, atëherë e kopjojnë të njëjtin plan edhe për atë vit. Nga sa trajtuam në punim, nuk mund të pretendohet se ekziston një ndarje absolute midis tradicionales dhe bashkëkohores në fushën e të dhënimit mësim dhe në të nxënë. Ajo që është parësore brenda këtij procesi nuk është rruga që ndjek mësuesi dhe veprimtaria e tij, por ajo që do të arrijnë nxënësi. Çdo metodë, teknikë dhe strategji mësimore, qoftë tradicionale ose bashkëkohore nuk do të ketë sukses, mbase mund të llogaritet e dështuar, nëse nuk do të japë rezultate të parashikuara. Ajo që arritëm të konstatojmë është se mësimi tradicional është më shumë teorik dhe memorizues dhe nuk ka si qëllim të zhvillojë aktivitete për t'i stimuluar nxënësit ta përdorin informacionin e marrë në situata reale. Prandaj nxënësit e humbasin interesin për mësim. Ndonëse kjo metodë ka si parim që nxënësit ta mësojnë dhe ta riprodhojnë informacionin e marrë, kjo nuk është efektive, sepse një informacion i mësuar mund të harrohet lehtë, ngase të mësuarit e tij mbetet thjesht te memorizimi dhe riprodhimi". Mangësia e mësimi tradicional qëndron te planifikim jokorrekt, që shkon në epërsi të mësuesit, duke orientuar një mësimdhënie me në qendër mësuesin.

Procesi mësimor si veprimtari që organizohet me materie të gjallë kërkon një përkujdes të posaçëm nga ata faktorë që e ndihmojnë suksesin e tij (mësuesi-nxënësi). Zhvillimi i teknologjisë së informacionit, që po ndodh me hapa gjigande, bën që interesimi, prirja dhe kureshtja e nxënësit të sotshëm të dallojë dukshëm nga ajo e nxënësit të dikurshëm. Si pasojë e këtij reformimi, në procesin mësimor kërkohet një mësues që di dhe përdor teknologji të reja në çdo orë mësimore, në çdo veprimtari shkollore e jashtëshkollore në dobi të të nxënësit.

Mendojmë se do të ishte një hap pozitiv nëse të gjithë mësimdhënësit do të përpqeshin të bëjnë modifikime nga më të ndryshmet gjatë realizimit të procesit mësimor, duke kombinuar metoda, teknika dhe strategji të shumëllojshme, të njohura, por jo shumë të përhapura në arsimin shqip. Kombinimet e tilla e ndihmojnë mësuesin për të arritur rezultate më të mira dhe për t'i kuptuar prirjet dhe aftësitë e secilit nxënës në veçanti. Një nxënie e tillë u siguron një paraqitje dhe përgatitje të mirë nxënësve, duke qenë se bazohen në njohuri të qëndrueshme dhe afatgjatë, pra ofron mundësi të shumta për ta orientuar nxënësin drejt njohjes së të ardhmes së realizueshme, të afërt dhe të mundshme.

Bibliografia:

- Адамческа, Снежана: *Активна настава*, Легис, Скопје, 1996
- Brada, Riza: *Metodika e gjuhës shqipe për shkollën fillore, botimi III i plotësuar*, Dukagjini, Pejë, 2005.
- Диздаревик, Д. Јасмина: *Дидактика на јазично подрачје во основното образование*, Просветно Дело, Скопје, 2003.

- Donald C. Orlich, Robert J. Harder, Richard C. Callahan, Konstance H. Kravas, Donald H. Kauchak, R. A. Pendegrass, Andrew J. Keogh: *Strategjia e të mësuarit*, Eureka, Tiranë, 1995.
- Garo, Sofokli: *Metodologjia dhe praktika e mësimdhënies*, U.F.O. Press, 2001.
- Grillo, Kozma: *Fjalor edukimi*, Dita, Tiranë, 2002.
- Gjokutaj, Mimoza: *Didaktika e gjuhës shqipe*, SHBLU, Tiranë, 2009.
- Krasniqi, Islam: *Mendimi metodik dhe praktika e mësimit të gjuhës shqipe, (periodiku pedagogjik në gjuhën shqipe midis viteve 1945-1978)*, Libri shkollor, Prishtinë, 2004.
- Memushaj, Rami: *Hyrje në gjuhësi*, Toena, Tiranë, 2006.
- Musai, Bardhyl: *Mjeshtritë themelore të mësimdhënies*, Tiranë, 1997.
- Musai, Bardhyl: *Metodologjia e mësimdhënies*, Albgraf, Tiranë, 2003.
- Mustafa, Avzi: *Didaktika e gjuhës shqipe dhe e leximit letrar*, Logos A, Shkup, 2004.
- Poljak, Vladimir: *Didaktika*, Školska knjiga, Zagreb, 1985.
- Rama, Besnik: *Metodat e mësimdhënies dhe ndikimi i tyre në të nxënë*, Revista pedagogjike, Tiranë, 2011.
- Rrokaj, Shezai: *Çështje të gjuhës shqipe*, Albatros, Tiranë, 2007.
- Rrokaj, Shezai: *Hyrje në gjuhësinë e përgjithshme*, Tiranë, 2005.
- Thomason, Tommy & Ward, Geoff: *Tools not rules teaching grammar in the riting classroom*, USA, 2009.
- Vuković, Jovan & Težak, Stjepko & Brabec, Ivan & Marek, Juraj: *Savremene nastava matarnjeg jezika*, Zavod za izdavanje udžbenika-Sarajevo, 1965.
- Zulfu, Nijazi: *Didaktika*, ALBSHTANZC, Prishtinë, 2001.
- <http://iipcccl.org/wp-content/uploads/2017/12/Vol.-1-ICES-IV.pdf>, marrë më 26.05.2019.
- <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2013/10/Doktoratura-Besnik-Rama-Fakulteti-i-Histori-Filologjise-Departamenti-i-Gjuhesise.pdf>, marrë më 15.06.2019.